



UK Health
Security
Agency

NHS

Mbroni veten kundër
**meningjitit dhe
septikemisë**
me vaksinën MenACWY



immunisation
the safest way to protect your health

Sëmundje meningokokale

Sëmundja meningokokale është e rrallë, por shumë e rëndë dhe kërkon trajtim urgjent spitalor. Mund të çojë në paaftësi që ndryshojnë jetën si prerje kirurgjikale të gjymtyrëve, humbje dëgjimi, dëmtime të trurit dhe plagë. Shkaktohet nga bakteret meningokokale të cilat ndahen në disa grupe. Më të zakonshmet janë A, B, C, W dhe Y. Foshnjat, fëmijët e vegjël, adoleshentët dhe të rriturit e rinj kanë rrezikun më të lartë të sëmundjes meningokokale.

Bakteret meningokokale mund të shkaktojnë meningjit (inflamacion i cipës së trurit) dhe septikemi (kur bakteret hyjnë në qarkullimin e gjakut për të shkaktuar helmim të gjakut). Të dyja sëmundjet janë shumë të rënda dhe mund të shkaktojnë vdekje, veçanërisht nëse nuk diagnostikohen herët.

Si meningjiti ashtu edhe septikemia mund të shkaktojnë sepsis. Sepsis është një përgjigje e madhe e imunitetit dhe kërcënuese për jetën ndaj çdo infeksioni dhe mund të çojë në dëmtim të indeve, dështim të organeve dhe vdekje.

Pse më duhet të bëj vaksinën?

Adoleshentët më të mëdhenj dhe të rinjtë janë në rrezik më të lartë për t'u prekur nga sëmundje meningokokale, kështu që ju duhet të vaksinoheni tani për të mbrojtur veten. Kjo është një vaksinë e sigurt dhe shumë efektive që ka qenë pjesë e programit rutinë të adoleshencës që nga viti 2015. Gjithashtu ul rrezikun që personat e tjerë rreth jush të infektohen. Ju mund të keni bërë vaksinimin MenC si foshnjë dhe vogëlush, por kjo nuk do t'ju mbrojë kundër grupeve të tjera meningokokale.

Vaksina MenACWY do të rrisë mbrojtjen tuaj kundër MenC dhe do t'ju ndihmojë të mbroheni ndaj tre grupeve të tjera meningokokale (A, W dhe Y). Kjo vaksinë nuk do t'ju mbrojë kundër të gjitha llojeve të sëmundjes meningokokale, si MenB, edhe prandaj është ende e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për shenjat dhe simptomat.

A duhet ta bëj vaksinën MenACWY?

Jo, por mënyra më e mirë për të ndihmuar në mbrojtjen e vetes është të bëni vaksinën MenACWY. Ju, ose prindi/kujdestari juaj, duhet të jepni lejen për ta bërë vaksinën. Zakonisht do t'ju ofrohet vakcina në shkollë në vitin e 9-të kur të jeni 13-14 vjeç. Mos u shqetësoni nëse e keni humbur vaksinimin, ju keni të drejtë ta bëni vaksinën MenACWY falas nga infermierja e shkollës ose ekipi i imunizimit të shkollës nëse jeni ende në shkollë apo nga mjeku juaj i përgjithshëm, deri në ditëlindjen tuaj të 25-të. Ka 3 vakcina MenACWY, ato quhen MenQuadfi, Nimenrix dhe MenVeo, ju mund të lexoni fletëpalosjet e Informacionit të Pacientit këtu:

MenQuadfi: [medicines.org.uk/emc/product/12818/pil](https://www.medicines.org.uk/emc/product/12818/pil)

Nimenrix: [medicines.org.uk/emc/product/4118/pil](https://www.medicines.org.uk/emc/product/4118/pil)

MenVeo: [medicines.org.uk/emc/product/2939/pil](https://www.medicines.org.uk/emc/product/2939/pil)

A të dhemb vakcina?

Askush nuk i pëlqen injeksionet, por është shumë e shpejtë. Gjilpërat e përdorura janë të vogla dhe duhet të ndjeni vetëm një pickim të vogël. Nëse jeni pak në ankth për të bërë injeksionin, tregojini infermieres ose mjekut përpara se ta bëni atë.

Shenjat dhe simptomat

Fillimisht sëmundja meningokokale mund të jetë si një rast i keq i gripit. Por kushdo i prekur zakonisht sëmuret rëndë brenda pak orësh. Trajtimi i hershëm mund t'ju shpëtojë jetën, kështu që është e arsyeshme të jeni të vetëdijshëm për disa nga shenjat dhe simptomat kryesore.

Dhimbje koke e fortë

Qafë e ngrirë

Temperaturë e lartë

Konvulsione/dridhje
epileptike

Gjendje e përgjumur ose
vështirësi zgjimi nga gjumi

Konfuzion dhe/ose
nervozizëm

Duar dhe këmbë të ftohta

**Jini të vetëdijsh
shenja dhe si
zakons**

Mund të zhvillohen një ose më shumë nga këto simptoma dhe ato mund të shfaqen në çdo mënyrë dhe të përzihen midis dy sëmundjeve. Është e rëndësishme të kërkonti këshilla mjekësore të hershme nëse ju ose një mik keni simptoma shqetësuese ose një gjendje që po përkeqësohet me shpejtësi.

Është e rëndësishme të njihni shenjat dhe simptomat e meningjitit dhe septikemisë edhe nëse jeni i/e vaksinuar pasi ka shumë shkaqe të tjera të këtyre gjendjeve.

Mospëlqimi i dritës së ndritshme

Frymëmarrje e shpejtë

Të vjella/diarre

**Pykshëm për këto
e simptoma të
nshme**

Ngërçe në stomak

Lëkurë e zbehtë me njolla

Puçrra/skuqje mavijosje*

Dhimbje të kyçeve ose muskujve

Një përshkrim i plotë i shenjave dhe simptomave të meningjitit dhe septikemisë përfshirë imazhet dhe videot mund të gjenden te www.meningitis.org dhe www.meningitisnow.org

*shihni "Bëni testin e gotës prej xhami" në pjesën e sipërme

Bëni testin e gotës prej xhami

Dikush me septikemi mund të zhvillojë disa njolla ose një skuqje të përhapur me ethe. Më vonë skuqja mund të zhvillohet në njolla vjollce që nuk zbehen nën presion. Ju mund të bëni një test për këtë duke shtypur anën e një gote pijeje ndaj skuqjes. Nëse keni temperaturë dhe skuqje dhe puçrrat nuk zbehen nën shtypje, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore duke telefonuar 999 ose i thoni dikujt që t'ju çojë në departamentin e urgjencës së spitalit më të afërt. Asnjëherë mos prisni për një acarim lëkure me puçrra. Mund të jetë një shenjë e vonë ose mund të mos shfaqet fare. Nëse dikush është i sëmurë dhe përkeqësohet, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.

Në lëkurën e errët, kontrolloni brenda qepallave ose qiellzës së gojës ku njollat mund të jenë më të dukshme.



A ka ndonjë efekt anësor?

Është e zakonshme të keni pak ënjtje, skuqje ose butësi aty ku bëni injeksionin. Ju gjithashtu mund të keni dhimbje koke ose në përgjithësi të ndiheni pak jo mirë, por këto simptoma duhet të zhduken pas një ose dy ditësh. Nëse jeni të shqetësuar për ndonjë simptomë, kërkoni këshilla mjekësore si zakonisht përmes NHS111 ose klinikës së mjekut tuaj të përgjithshëm.



Nëse keni ndonjë efekt anësor të dyshuar të vaksinës, mund t'i raportoni këto në faqen e internetit të Yellow Card (Kartoni i Verdhë), duke telefonuar në numrin 0800 731 6789 (09:00-17:00, nga e hëna në të premte) ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.

Për meningjitin, organizatat bamirëse të mëposhtme ofrojnë informacion, këshilla dhe mbështetje:

Meningitis Research Foundation (Fondacioni i Kërkimeve të Meningjitit), linja ndihme falas 080 8800 3344 – e hënë deri të premten, nga ora 9:00 deri në orën 17:00

Meningitis Now (Meningjiti tani), linja ndihmëse falas 0808 80 10 388 – e hënë deri të enjten nga ora 09:00 deri në orën 16:00 dhe të premten nga 9:00 deri në orën 13:00

Nëse keni ndonjë pyetje ose dëshironi më shumë informacion, bisedoni me mjekun tuaj, infermieren e shkollës ose infermieren e klinikës së mjekut tuaj.

Kjo fletëpalosje është prodhuar nga Agjencia e Sigurimeve Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar

© Crown copyright 2024

1P 100K AUG 2023 (APS). Product code: YPMACWY1AL Albanian.

UK Health Security Agency gateway number: 2024071.

Fletëpalosja mund të porositet ose shkarkohet nga:

www.healthpublications.gov.uk, duke telefonuar: 0300 123 1002

(linjat janë të hapura nga ora 08:00 deri në orën 18:00 nga e hëna në të premte).

Kopje letre të kësaj në fletëpalosje në anglisht janë të disponueshme për porosi.